

VENDIM
Nr. 385, datë 27.6.2018

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 285, DATË 13.4.2016, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR ‘HIDROCENTRALI I BANJËS–GRAMSH DHE URA E
TRASHOVICËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 285, datë 13.4.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat si më poshtë vijon:

1. Pas tabelës së përmendur në pikën 3 shtohet tabela nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Pas pikës 3 shtohet pika 3.1, me këtë përmbajtje:

“3.1 Vlerës totale të shpronësimit i shtohet shuma prej 251 516 (dyqind e pesëdhjetë e një mijë e pesëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekësh për pasurinë e llojit “drufrutorë.”.

3. Pas pikës 4 shtohet pika 4.1, si më poshtë vijon:

“4.1 Vlera e shpronësimit të pronarit, sipas këtij vendimi, në shumën prej 251 516 (dyqind e pesëdhjetë e një mijë e pesëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekësh, do të përballohet nga buxheti i shoqërisë “Devoll Hidropower” sh.a.”.

4. Pas pikës 5 shtohet pika 5.1, me këtë përmbajtje:

“5.1 Vlerës totale të shpenzimeve procedurale i shtohet shuma 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, e cila do të përballohet nga buxheti i shoqërisë “Devoll Hidropower” sh.a.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

Tabela nr. 2

LISTA E PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA NDËRTIMI
I SEGMENTIT RRUGOR "HIDROCENTRALI I BANJËS-GRAMSH DHE URA E TRASHOVICËS",
"PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 285, DATË 13.4.2016"

Nr.	Emër, atësia mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Vlera e kulturave bujqësore (drufrutore)	Vlera totale	Dokumenti i pronësisë
1	Nderim Skender Duzha	3103	101/3	Pemëtore	251 516	251 516	Konfirmuar nga ZVRPP-ja (diferencë vlere, pemë drufrutore)
	TOTALI					251,516	